



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 803 Prot.

Tiranë, më 23 . 05 . 2022

### V E N D I M

Nr. 93, Datë 23 . 05 . 2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 35, datë 04.02.2022, të I. D kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH) Korçë dhe Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, I. D, shprehet se i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuara dhe gëzon Statusin e të Verbërit. Ajo është studente pranë Fakultetit të Bujqësisë, në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, dhe ndjek programin e studimit 2-vjeçar me karakter profesional “Teknikat e Prodhimit të Farave e Fidanëve”, kursi i II-të<sup>2</sup>.

Ankuesja parashtron, ndër të tjera, se: “Duke patur statusin e të verbërit kam qenë përfituese e pagesës 300% për dy vite rresht. Gjatë kësaj periudhe nuk kam mundur të mbyll sezonin e dytë,

<sup>1</sup> Referuar Vendimit me nr. 78, datë 26.02.2021, lëshuar nga Komisioni Epror i Verbërisë, pranë Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), si dhe Librezës me nr. 17922, lëshuar nga SHSSH, ankuesja është përfituese e “Statusit të të Verbërit” (Grupi i I-rë) duke filluar nga data 01.11.2020 – 01.11.2025.

<sup>2</sup> Bazuar në Vërtetimet e datave: 28.01.2022 dhe 31.01.2022, të Fakultetit të Bujqësisë/Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

*për shkak të pandemisë COVID-19, pasi mësimi ka qenë on-line dhe e kisha të pamundur për ta ndjekur. Për këtë arsye, kam lënë sezonin dhe këtë vit jam në vazhdim të studimeve, ndërkohë që nuk më njihet pagesa e vitit plus, sipas përcaktimeve ligjore”.*

Në vijim ankuesja i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë dhe Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, të cilët i janë përgjigjur se nuk i takonte pagesa për vitin plus, sepse ka ndryshuar ligji.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Korçë për shkak të aftësisë së kufizuar, si dhe përfitimin e plotë të bursës bazuar në VKM nr. 227, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, të ndryshuar.

## **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 35, datë 04.02.2022, të bërë nga znj. Irena Dape, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 258/1, datë 08.02.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, DRSHSSH Korçë dhe Bashkia Korçë, për ankesën e bërë nga ankuesja si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
  - Argumentimin e subjekteve kundrejt të cilëve pretendohet diskriminimi, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
  - Informacion lidhur me arsyet e përjashtimit të ankuses nga përfitimi i pagesës 1 (një) vit plus për programin e studimit Master Profesional.
  - A ka patur ankesa të tjera nga persona me aftësi të kufizuara, të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me ankuesen, znj. D? Nëse po, a është vepruar në të njëjtën mënyrë dhe sa është numri i tyre? Kopje të praktikës së mbajtur për secilin rast.
  - A ka paraqitur znj. D, ankesë pranë DRSHSSH Korçë dhe Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, lidhur me pretendimet e ngritura? Nëse po, kërkohet një kopje e korrespondencës.
  - Si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Me shkresën nr. 271/1, datë 16.02.2022, DRSHSSH Korçë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Shtetasja I. D, trajtohet me pagesë paaftësie (status verbërie).

*Znj. D ka filluar programin e 2-vjeçar me karakter profesional “Teknikat e Prodhimit të Farave e Fidanvë”, pranë Universitetit Fan S.Noli, Korçë, në vitin 2019.*

*Për vitin akademik 2019-2020 ka marrë pagesë 300%, për shkak të frekuentimit të arsimit të lartë, të parashikuar sipas pikës 7, VKM nr. 277, datë 18.06. 1997 “Për përfitim nga Statusi i të Verbërve”.*

*Znj. D ka paraqitur pranë Bashkisë Korçë, Vërtetimin me datë 06.01.2020, sipas të cilit vërtetohet se për vitin akademik 2019-2020 ka qenë frekuentuese e Kursit të I-rë.*

*Gjithashtu kjo shtetase ka përfituar pagesën 300% edhe për vitin akademik 2020-2021, pasi ka paraqitur vërtetimin me datë 06.11.2020, lëshuar nga Universiteti i Korçës, Fakulteti i Bujqësisë.*

*Referuar vërtetimeve të sipërpërmendura rezulton se znj. D, ka qenë frekuentuese e programeve të studimit, Kursi i I-rë për vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021. Shtetasja Irena Dape pretendon se për vitin akademik 2020-2021 nuk ka mundur të ndjekë procesin mësimor dhe e ka lënë, për shkak se mësimi është zhvilluar online si pasojë e pandemisë Covid-19.*

*Pretendimi nuk qëndron pasi shtetësja ka qenë frekuentuese e procesit mësimor, kursi i II-të, viti akademik 2020-2021, vërtetuar kjo me dokumentacionin e paraqitur në Institucion.*

*Në interpretim të pikës 7, të VKM 277, datë 18.06.1997, përfitimi i pagesës (një vit shtesë përtej ciklit normal të studimit) në masën 300%, nuk është rregull, por rast përjashtimor. Që të kryhet kjo pagesë përtej ciklit normal të studimit duhet që përfituesi i pagesës, minimalisht të vërtetojë shkaku ose arsytet të cilat e kanë penguar të ndjekë rregullisht studimet brenda vitit të caktuar akademik.*

*Bashkia Korçë, pasi ka administruar të gjithë dokumentacionin, ka konkluduar se znj. D, jo vetëm që nuk ka provuar pretendimin e saj, por nga dokumentacioni që ne disponojmë, vërtetohet se ka qenë frekuentuese e procesit mësimor për vitin akademik 2020-2021.*

*Ne si institucion kemi vepruar në zbatim të legjislacionit përkatës, duke u përpjekur që në çdo moment të shmangim rastet e abuzimit, përse i përket pagesave shtesë, një vit përtej ciklit normal të studimit.*

*Dokumentacioni provues i kërkuar nga ana e Bashkisë Korçë është një kërkesë legjitime dhe e drejtë nisur nga kushtet specifike që ka rasti konkret. Kjo kërkesë vjen në zbatim të Kodit të Procedurës Administrative.*

*Në përfundim gjykojmë se, ndërprerja e pagesës është kryer konform ligjit dhe se kryerja e pagesës për vitin plus nuk është e justifikuar. Gjithashtu ju bëjmë me dije se, institucioni jonë është shumë sensitiv ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuar dhe në asnjë rast nuk ka diskriminuar, për asnjë shkak të vetëm, këtë kategori”.*

Me shkresën nr. 920/1 prot., datë 21.02.2022, Bashkia Korçë dërgoi të njëjtat parashtrime si DRSHSSH Korçë.

2. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës me nr. 258/4 prot., datë 21.04.2022 *“Njoftim për seancë dëgjimore”*, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 05.05.2022<sup>3</sup>.

Gjithashtu, ditën e realizimit të seancës dëgjimore, Komisioneri kërkoi nga subjektet kundër të cilëve janë paraqitur ankesat e mësipërme, parashtrime me shkrim mbi pretendimet e subjekteve ankues, duke na informuar mbi çështjet si më poshtë:

- Kopje të plotë të dosjes së përfitimit të trefshit të pagesës për ndjekjen e arsimit të lartë të ankueses, për vitet akademike: 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021.
- Informacion nëse DRSHSSH Korçë dhe Drejtoria e Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, kanë miratuar përfitimin e pagesës (një vit shtesë përtej ciklit normal të studimit) për ndonjë student. Nëse po, kopje të dosjes.
- Ankuesit të dërgojnë prova, se kanë dorëzuar pranë DRSHSSH Korçë ose Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, dokumentacion lidhur me arsyen/t e mosfrekuentimit të studimeve, për vitin akademik 2020-2021 dhe që kanë kërkuar përfitimin e pagesës për këtë vit.
- Si dhe çdo informacion tjetër që gjykohet i arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Në përgjigje të njoftimit për seancën dëgjimore, DRSHSSH Korçë, me e-mail-in datë 28.04.2022, informoi se: *“Pasi u morën në shqyrtim të gjitha shkresat, përsa i përket drejtorisë sonë, ne nuk kemi asnjë pretendim dhe pagesat mund të kryhen vetëm nëse personat pretendues paraqesin vërtetimet e shkollës për vitet e prapambetura, për të cilat pretendojnë pagesat”*.

Në vijim të procedurës hetimore, Bashkia Korçë me shkresën nr. 3089/1, datë 12.05.2022, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Pas kontakteve të marra me ankuesit në bashkëpunim dhe me përfaqësuesen e zyrës së KMD-së, këta shtetas kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, për shlyerjen e pagesave të prapambetura. Për sa më sipër, çështja u zgjidh me ndërmjetësimin e KMD-së dhe Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë”*.

---

<sup>3</sup> Me e-mail-in datë 04.05.2022, përfaqësuesja e Bashkisë Korçë informoi se për arsye shëndetësore dhe familjare, kërkon shtyrjen e zhvillimit të seancës dëgjimore.

Me e-mail-in datë 28.04.2022, përfaqësuesja e DRSHSSH Korçë informoi se nuk kanë parashtrime të tjera lidhur me çështjen dhe për arsye të ngarkesës në punë, nuk mund të marrë pjesë në seancën dëgjimore.

Me e-mail-in datë 05.05.2022, palët u informuan për shtyrjen e zhvillimit të seancës dëgjimore, për në datë 13.05.2022.

Në vijim ankuesja me shkresën<sup>4</sup> e dërguar me e-mail-in datë 12.05.2022, informoi Komisionerin se tërhiqet nga ankesa, pasi kërkesa e saj për përfitimin e pagesës për vitin shtesë të studimeve ishte realizuar me ndërmjetësimin e palëve në proces.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 35, datë 04.02.2022, të I. D, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

---

<sup>4</sup> Protokolluar pranë KMD-së me datë 17.05.2022.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: AK

Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti